



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:084496

Datë: 18.10.2021

Numri i dokumentit: 02288531

PA1.nr.989/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarës M. H. – S., nga Prishtina, për shkak të veprës penale mos raportimi apo raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par. 2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1630/20, të datës 05.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.10.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1630/20, të datës 05.07.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1630/20, të datës 05.07.2021, është liruar nga akuza e akuzuara M. H. – S., në kuptim të nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK, për shkak të veprës penale mos raportimi apo raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par. 2 të KPK, për shkak se nuk është provuar se e njëjta e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës penale, lidhur me këtë çështje penale, kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe e akuzuara të shpallet fajtores për veprën penale e cila i vihet në barrë, apo që i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1006/2021, të datës 03.08.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se me rastin e nxjerrjes së këtij aktgjykimi nga gjykata e shkallës së parë, e njëjta ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse me arsyetimin e bërë lidhur me dispozitivin e aktgjykimit kemi paqartësi dhe kundërshtim mes tyre, pasi që arsyetimi nuk ka arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare sidomos në vlerësimin e provave ku të gjitha provat e prezantuara në shqyrtim gjyqësor kanë qenë në favor të aktakuzës, e që gjykata pa asnjë vlerësim lidhur me provat ka nxjerrë aktgjykim lirues ndaj të akuzuarës. Arsyetimi i aktgjykimit nuk përkon me dispozitivin e aktgjykimit, pasi që provat e prezantuara dhe të specifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu, edhe në arsyetimin e aktgjykimit konstatojnë fajësinë e të akuzuarës e cila me vetëdije dhe dashje të plotë nuk e ka deklaruar biznesin e saj të regjistruar në Angli – Londër, të cilin fakt e ka pranuar edhe vet e akuzuara, si gjatë marrjes në pyetje nga ana e prokurorit po ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ndërsa, për sa i përket arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë se e akuzuara nuk ka bërë ndonjë mos deklaram të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, kjo nuk qëndron, pasi që në këtë rast nuk kemi të bëjmë me fshehjen e asgjëje të paligjshme, por me mos deklaramin respektivisht mos raportimin e biznesit të ligjshëm të akuzuarës. Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur të bëjë dallimin mes falsifikimit dhe mos deklaramit, e akuzuara është akuzuar për mos deklaram të pasurisë, përkatësisht biznesit të saj. Mbi këtë bazë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i paqëndrueshëm, i paarsyetuar, i përgjithësuar dhe për këtë duhet të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e prokurorisë, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat shkelje ky kolegji përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara nga neni 384 i KPPK, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten si dhe pjesët tjera të aktgjykimit, sepse përmban arsye lidhur me faktet vendimtare, të cilat pasi që janë vlerësuar, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vendosur që të akuzuarën ta liroj nga fajësia, sepse nuk është vërtetuar se në veprimet e saj, janë formuluar elementet qenësore të veprës penale, mos raportimi apo raportim i rremë i pasurisë i të

ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale, ose detyrimeve financiar nga neni 437 par.2 të KPK. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur arsyet për secilën pikë të aktgjykimit, e gjithashtu ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat prova dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara apo të pavërtetuara për vendosjen e çështjes penale. Po ashtu, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban formën e kërkuar në kuptim të nenit 370 të KPPK, pasi që i njëjti përmban formën e paraparë me shkrim, duke përmbajtur të gjitha pjesët që duhet ti përmbaj aktgjykimi.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, mirëpo pa dhënë ndonjë arsye përkitazi me këtë bazë ankimore për të cilën e ka ushtruar ankesën. Mirëpo, përkundër që prokuroria nuk ka dhënë asnjë arsye përkitazi me shkeljet e ligjit penal nga neni 385 i KPPK, kolegji i kësaj gjykate e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, se a përfshihet i njëjti me shkeljet e ligjit penal, për të cilat shkelje ky kolegji përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale nuk kemi të bëjmë me shkelje të ligjit penal, për shkak se në çështjen penale konkrete kanë ekzistuar rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarës, si dhe ndjekjen penale të saj, se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kuadër të kompetencave ligjore, se është aplikuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën kur pretendohet të jetë kryer vepra penale, andaj gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të ligjit penale me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë gjendja faktike është vërtetuar gabimisht, ngase nga provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, bindshëm është vërtetuar se e akuzuara me vetëdije dhe dashje direkte e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, kjo për faktin se edhe vet gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit, nuk e konteston se kompania e të akuzuarës ka qenë e regjistruar dhe ka pasur në pronësi dhe asete në vlerë prej 2884 funta britaneze, të dhëna këto të publikuara në Regjistrin e Kompanive të Shtëpisë së Kompanive për Angli dhe Wells, e po ashtu edhe fakti se biznesi i të akuzuarës “XXXXX” është shpërbërë më dt. 05.03.2019, pra dy vite pasi e akuzuara ka qenë e emëruar si zyrtare e lartë publike. Gjykata në rastin konkret do të duhej mbështetur edhe në vërtetimin e gjendjes faktike të konstatuar nga aktgjykimi P.nr.1250/19 i dt. 18.10.2019, i cili të akuzuarën e ka shpallur fajtorë për të njëjtën veprë penale. Në këtë aktgjykim, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se e akuzuara nuk e ka deklaruar saktë pasurinë e saj, respektivisht zotërimin e aksioneve në formularin për deklarimin e pasurisë, ku në faqen 4 të tij, kërkohet nga zyrtari i lartë publik që të deklaroj “Zotërimin e Aksioneve në Shoqëri Tregtare”, e çka në rastin konkret e akuzuara nuk e ka bërë, duke shkelur kështu nenin 5 par. 1.3 dhe nenin 6 par. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik. Ky fakt u vërtetua edhe nga ana e të akuzuarës, e cila në pyetjen e prokurorit deklaroi se ka qenë e vetëdijshme për këtë obligim ligjor, por e njëjta me qëllim nuk e ka bërë, pasi që është konsultuar me avokatin e saj në Britani të Madhe, dhe se pasi që biznesi i saj, gjoja ka qenë jo aktiv, edhe pse sipas të akuzuarës, biznesi në fjalë ka qenë aktiv deri më dt. 05.03.2019. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike të argumentuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, në bazë të sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, me aktvendimin e saj PA1.nr.77/2020, ku ka kërkuar që të vërtetohet se vepra penale e lartcekur, a është kryer me dashje nga e akuzuara, e që gjatë shqyrtimit gjyqësor, një gjendje e tillë është vërtetua pa mëdyshje, pasi që e akuzuara me qëllim dhe dashje direkte nuk e ka deklaruar biznesin e saj. Ky aktgjykim, nuk i përmban as konditat minimale të aktgjykimit me shprehjet e përdorura dhe mos arsyetimi e liritimit të akuzuarës nga përgjegjësia penale, pasi që nuk është arsyeja që e akuzuara në cilësinë e këshilltares së kryeministrit të marr këshillë nga avokati në Londër, për të mos deklaruar biznesin.

Po ashtu, është me rëndësi të kuptohet fakti se e akuzuara ka filluar procedurën e ç' regjistrimit vetëm kur prokuroria ka filluar procedurën penale. Andaj, gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësim jo të drejtë të dispozitave ligjore lidhur me veprimet e të akuzuarës në raport me pasojën e veprës penale. Gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin në çështje imagjinare pa dhënë konstatime të bazuara në ligj dhe në prova konkrete që i ka përmbajtur aktakuza.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga ana e prokurorisë, si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Kjo gjendje faktike është vërtetuar nga provat e administruara në shkresat e lëndës, sikurse janë formulari për deklarin e pasurisë i dt. 10.10.2017 me nr. prot. 03-/5193/19, kërkesa e AKK e dt. 07.02.2019, kallëzimi penal nga BIRN 2970 i dt. 10.01.2019 dhe Intern Kosova, Certifikata e Kompanisë “XXXXX” me nr. 111111, Aplikacioni i regjistrimit të biznesit IN01 (ef), Përbërja e kompanisë, kapitali i kompanisë, aksionet e M. H. – S., autorizimi, memorandum, zhvillimi i kapitalit të kompanisë për vitin 2016, 2017, lidhur me bilancin e gjendjes e dt. 30.07.2017, parashtrësia e dt. 15.02.2019 nga “XXXXX”, vendimi i zyrës së kryeministrit të dt. 11.09.2017, Formularët për deklarin e pasurisë për të pandehurën për vitin 2018 dhe vitet paraprake për të gjithë zyrtarët publik si dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Përgjigja në kërkesë e dt. 12.03.2021 nga autoritetet Britaneze e pranuar në gjykatë me dt. 16.03.2021 përmes Ministrisë së Drejtësisë – zyra për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, provat e dorëzuara nga mbrojtësja e të pandehurës në seancën e dt. 01.06.2021, sipas të cilave kompania është ç' regjistruar më dt. 05.03.2019 dhe nuk ka vepruar në asnjë transaksion pas dt. 30.09.2017. Për gjykatën e shkallës së parë nuk ishte kontestues fakti se e akuzuara më dt. 28.09.2015 në Londër kishte hapur biznesin “XXXXX”, ku vlera e aksioneve ishte 10 funta, pasi që një aksion kishte vlerën e një funte, e po ashtu nuk ishte kontestues fakti se e akuzuara më dt. 30.09.2017, kishte në pronësi asete në vlerë prej 2355 funta, pasi që ishin zbritur shpenzimet në vlerë prej 963 funtave nga shuma prej 1884 funta, dhe me këtë datë një euro ishte e baras vlefshme me 0.8765, dhe në total vlera e aseteve prej 2355 funtave në euro ishte 2686 euro e 82 cent, nga të cilat 434 funta ishin asete fikse, të cilat i kishte deklaruar më dt. 29.06.2018, për bilancin deri më dt. 30.09.2017, të dhëna këto të cilat janë publike në Regjistrin e Kosovës për Regjistrimin e Bizneseve. Nuk është kontestues as fakti se ky biznes është shpërbërë më dt. 05.03.2019. Kontestuese ishte vetëm fakti se mos deklarimi i biznesit në pronësi të akuzuarës i quajtur “XXXXX”, i regjistruar në Londër, në formularin për deklarin e pasurisë të dt. 10.10.2017, me rastin e marrjes së detyrës nga ana e të akuzuarës në pozitën e këshilltares në zyrën e kryeministrit më dt. 11.09.2017 dhe deklarin e rregullt me dt. 26.03.2018, për vitin paraprak a ishte i qëllimshëm apo jo, nëse po, cili ishte qëllimi i tij. Me nenin 437 par. 2 të KPK, është paraparë në mënyrë decidive se këtë veprë penale e kryen “Çdo person i cili sipas ligjit është detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të ardhurave, të dhuratave, të dobisë pasurore ose detyrimeve financiare i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë”. Në rastin konkret e akuzuara në formularin e saj për deklarin e pasurisë nuk ka falsifikuar asgjë, e as nuk ka përdorur ndonjë dokument apo të dhënë të falsifikuar në formularin për deklarin e pasurisë. Elementi tjetër i kësaj veprë penale është se “nuk paraqet të dhëna të kërkuara në deklaratë”, ndërsa në rastin konkret e akuzuara, i ka paraqitur të dhënat e kërkuara në deklaratë dhe atë duke plotësuar të gjitha rubrikat e formularit duke paraqitur tërë pasurinë e saj dhe atë të përbashkët me bashkëshortin e saj, si dhe dhuratat, mirëpo në deklarin e saj nuk e ka paraqitur vetëm biznesin në pronësi të quajtur “XXXXXX” të regjistruar në Londër, të cilin biznes e kishte hapur me dt. 28.09.2015, e për të cilin deklaroi se ka vlerësuar se biznesi në momentin e marrjes së detyrës si këshilltare në zyrën e kryeministrit, nuk ka pasur transaksione dhe sipas legjislacionit Britanez ka qenë jo funksionale, dhe kjo ka qenë arsyeja e mos deklarimit. Nga provat e administruara është vërtetuar se në veprimet apo mosveprimet e të akuzuarës nuk ekziston dashja për të kryer veprë penale.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.989/2021, të datës 12.10.2021

Sekretarja juridike,
Fitnete Hoti

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri